

Analiza Vjetore 2022, për Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore

Më datë 16 shkurt 2023, në mjediset e KLSH u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore (DAIQ), e cila u fokusua në prezantimin e rezultateve të Departamentit për vitin 2022, problematikat e shfaqura, si dhe sfidat për të ardhmen.

Drejtori i Departamentit z. Kozma Kondakçiu, paraqiti raportin mbi veprimtarinë e Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore për vitin 2022 si dhe objektivat e synimet për të ardhmen.

Gjatë vitit 2022, nga DAIQ janë kryer 22 Auditime ne institucione qendrore të sektorit publik, ministri, dhe agjenci të varësisë së tyre, institucione të pavarura, si dhe është vijuar me procesin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Të klasifikuara sipas 'Fushave' auditimet e kryera gjatë vitit 2022 nga DAIQ paraqiten:



- Në fushën e 'Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare' 2 auditime;
- Në fushën e 'Infrastrukturës dhe Energjisë'4 auditime;
- Në fushën e 'Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale'4 auditime;
- Në fushën e 'Kulturës'2 auditime;
- Në fushën e 'Drejtësisë'3 auditime;
- Në fushën e 'Arsimit'2 auditime;
- Në fushën e 'Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural'1 auditim;
- Në fushën të 'Tjera'2 auditime.

Ne vijim z. Qeram Cibaku Kryeauditues i Departamentit në diskutimin e tij theksoi nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së auditimeve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë që në procesin e hartimit të programit të auditimit, dokumenteve të raportimit të auditimit në mënyrë që të jenë të plota, të sakta, objektive, të bindshme, të qarta, koncize dhe me një pamje të përshtatshme dhe të kuptueshme për subjektet, parlamentarët, opinionin publik etj.

Në analizë pjesëmarrësit ndoqën e diskutuan mbi prezantimet:

- Problematikat e hasura në procedurat e investimeve përgatitur nga z. Aldo Kume.
- Problematikat e hasura në Auditimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” nga z. *Delor Prosi*.
- Problematikat e konstatuara nga auditimet e kombinuara, nga zj. *Joniada Goçaj* e zj. *Anjeza Gjoci*.

I pranishëm në këtë analizë ishte Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve z. Bexhet Zeqiri, i cili bëri prezent problematikat e shfaqura në auditimet e evaduar në vitin 2022. Në kuadër të raportimit, një angazhim serioz do t'i kushtohet unifikimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të cilat kanë tipologji të njëjtë, në subjekte të ndryshme, si dhe formulimit dhe klasifikimit të saktë të gjetjes dhe rekomandimit në funksion të rritjes së veprimtarisë audituese të KLSH.